



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: MUZEOLOGJI

Pedagogu: PhD.c. Edlira Çaushti

Ngarkesa: 6 ECTS (45 leksione dhe 15 seminare)

Lloji i lëndës: disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)

Programi i studimit: bachelor

Viti/Semestri: II/I

EKSTRAKT

Kjo lëndë ka për qëllim, njohjen me historinë e koleksioneve të para si dhe me përkufizimin dhe konceptin e Muzeut. Muzeologjinë dhe Muzeografinë. Ka për qëllim gjithashtu të bejë një njohje të përgjithshme me historinë dhe natyrën kronologjike të muzeumeve botërore deri në shekullin XX, duke analizuar evoluimin e koncepteve si dhe natyrën e zhvillimit të muzeve dhe koleksioneve muzeore. Një leksion do të foluset edhe në fillimet dhe hapat e parë të muzeologjisë shqiptare, qysh në dokumentet e para historike e deri në ditët tona. Key study do të behet edhe studimi dhe rekomandimet konkrete lidhur me nevojat e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë duke u njohur me muzeun konkretisht, pavionet dhe koleksionet e tij. Do të evidentohet edhe Etika profesionale, duke u shoqëruar me key-study për të konkretizuar leksionet teorike që lidhen me të. Qëllim i lëndës është edhe marrja e nocioneve bazë mbi menaxhimin e koleksioneve, dokumentimi, dhe inventarizimi i tyre si dhe organizimi i ekspozitave. Interpretimi dhe aksesibiliteti do të shoqërohen me key-study për të konkretizuar parimet dhe problematikat që hasen në muzeumet shqiptare.

Leksionet do të shoqërohen me vizita në Muzeume për të parë konkretisht, eksperiencat tona në këto fushë dhe për të parë nevojat që muzeumet kanë duke u bazuar në njohjet e përfuara gjatë leksioneve.

TEMAT:

LEKSION 1. Përkufizimi i Muzeut. Muzeologjia dhe Muzeografia. Fillesat dhe historia e koleksioneve.

LEKSION 2. Historia e Muzeumeve dhe e koleksioneve në botë deri në shekullin XX.

LEKSION 3. Historia e Muzeologjisë shqiptare.

LEKSION 4. Transformimi i Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, Rekomandime dhe propozime për hapat e ardhshëm dhe komiteti drejtues.

LEKSION 5. Lojet e ndryshme të muzeve, standartet minimale dhe etika profesionale në muze.

LEKSION 6. Manaxhimi i koleksioneve muzeale dhe kujdesi për to.

LEKSION 7. Inventari dhe dokumentimi në koleksionet muzeale.

LEKSION 8. Vitrina, ekspozime dhe ekspozita.

LEKSION 9. Kujdesi për vizitorët (grupmoshat si dhe persona me nevojë të veçanta shqisore dhe fizike) (aksesibiliteti).

LEKSION 10. Interpretimi në muzeume dhe ekspozita.

LEKSION 11. Edukimi në Muze, në kontekstin e funksioneve të muzeut.

LEKSION 12. Muzeu dhe dialogu ndërkulturor.

LEKSION 13. Manaxhimi i muzeut. Planifikimi i marketingut (ngritja e Brandit të muzeut).

LEKSION 14. Siguria nëpër Muzeume dhe përgatitja për dëme, rreziqe.

LEKSION 15. Trafiku i paligjshëm i objekteve të TK dhe Konventa.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**FREKUENTIMI:**

70% pranishë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjeshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)
25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)
20 % e notës përfundimtare

KONTROLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri
40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjeshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

1. BRITANICA

2. ADHAMI, STILIAN; MUZELOGJIA SHQIPTARE; TIRANE 2001; GREVIS.

3. TRANSORMIMI I MUZEUT HISTORIK KOMBETAR NE TIRANE, Rekomandime dhe propozime për hapat e ardhshëm nga komiteti drejtues. Tiranë Mars 2010 ; MDGIF and United Nations-Albania

4. Runing a museum (ICOM) A practical handbook.

<http://unesdoc.unesco.org/images/0014/001410/141067e.pdf>

5. O'NEIL, PAUL; The Culture of Curating and the Curating of Culture(s); Cambridge, Mass. 2012

6. Cataldo Luciana; Paraventi Marta, Il Museo oggi; LINEE GUIDA PER UNA MUSEOLOGIA CONTEMPORANEA; Editore: HOEPLI

7. Unidroit Convention on Stolen or Illegally exported Cultural Objects, Rome 1995.

8. LEM (the learning museums) Museums and intercultural dialogue, Report 4,

9. Tilden, F (1957) *Interpreting our heritage*, North Carolina Press (*my emphases*)

10. Laurajane Smith, *Uses of Heritage* (2006)